

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Gjuhë arabe IV

**Programi i studimit:** Studime Islame

**Numri i ECTS kredive:** 7

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 401

**Fondi i orëve:** 3+3

**Viti akademik:** 2015/2016

**Semestri:** VII

**Mësimdhënësi:** Prof. dr. Qazim Qazimi

## Përshkrimi i shkurtër e lëndës

Lënda gjuhë arabe IV përmban:

- Rasa kallëzore e emrit, emrat që sipas funksionit sintaksor qëndrojnë në trajtën e rasës kallëzore.
- Rasa gjinore me parafjalë, rasa gjinore me lidhje gjinore, rasa gjinore me përshtatje. Rasa gjinore me parafjalë- الجر بالحرف , parafjalët, kuptimet e parafjalëve, parafjalët e tepërta.
- Përcaktorët me përshtatje, përcaktorët me përshtatje nuk kanë rasë të veçantë, klasifikohen në pesë grupe: cilësori, lidhori, përforcimi, zëvendësimi, ndajshtimi.
- Fjalja- الجملة , dy kryegjymtyrët e fjalisë, gjymtyrë të dyta, fjali emërore, fjali foljore. Llojet e fjalive: Fjali pohore, Fjali mohore, Fjali kushtore, Fjali paskajore.

## Qëllimi i lëndës

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të përçojë te studentët e gjuhës arabe, konceptet dhe metodat kryesore të studimit të gjuhës arabe. Me lëndën e gjuhës arabe synohet që ti epet mundësi studentit që në formë kritike, madje duke nxitë debate, të kuptoj rëndësinë dhe rolin e arabishtes në zhvillimin e civilizimit njerëzor në përgjithësi e të qytetërimit Islam në veçanti, në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione në lidhje me zhvillimin e arabishtes.

Qëllimi i mësimi të lëndës gjuhë arabe është që të hulumtohen dhe të hetohen lëvizjet më të rëndësishme dhe metodat më të avancuara të nxënies dhe të praktikimit të gjuhës arabe në shkrim-lexim dhe komunikim, krahas asaj se gjuha arabe, është gjuhë bazike e literaturës burimore islame.

## Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi student do të jetë në gjendje:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të gjuhës arabe.  
Të krahasojnë zhvillimin e gjuhën arabe me gjuhët tjera semite.  
Të shkruajnë dhe lexojnë arabisht.  
Të komunikojnë në gjuhën arabe.  
Të flasin dhe të diskutojnë në gjuhën arabe.  
Të shfrytëzojnë arabishten si gjuhë bazike për literaturën burimore islame.  
Të hulumtojnë dhe të zbulojnë trashëgiminë kulturore islame në vend dhe jashtë.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Për metodologji të mësimdhënies lëndës së gjuhës arabe do të do të aplikohet dhe zhvillohet metodat si:  
Në formë të ligjëratave e që janë të obligueshme  
Përmes projektorit që mundëson pjesëmarrje aktive më masive të studentëve dhe koncentrim më të madh tek ligjëratat.  
Për mes ushtrimeve dhe analizave gramatikore në klasë, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur.  
Përmes konsultimeve në kabinete, dhe të stimulimit të studentëve ne diskutime interaktive. Përmes përgatitjes përgatitjeve të seminareve, eseve etj.

### **Përmbajtja e lëndës:**

#### **Java e parë:**

Hyrje në gramatikën e gjuhës arabe, Rasa kallëzore e emrit, Emrat që sipas funksionit sintaksor qëndrojnë në trajtën e rasës kallëzore. Kundrinori tautologjik. Ndërtimi i kundrinorit tautologjik në arabishte. Emër në paskajoren i i sajuar nga e njëjta temë e foljes së përmendur më herët. Ky kundrinor në arabishte shërben për të shprehur: përforsim të veprimit, numrin, a mënyrën e veprimit dhe gjithnjë qëndron në rasën kallëzore.

#### **Java e dytë:**

Kundrinori i drejtë, kundrinorë të drejtë marrin foljet kalimtare veprare, dhe ai vihet në rasën kallëzore pa parafjalë. Foljet abroguese-shfuqizuese të cilat marrin nga dy kodrinor, kundrinori i zhdrejtë- kundrinori me parafjalë,. : Kundrinori me parafjalën (**me-**و -), veçorit ë e tij, kushtet në të cilat ndërtohet, ushtrime sintaksore.

#### **Java tretë:**

Rrethanori, Rrethanori i kohës, Rrethanori i vendit, ndajfoljet e kohës të veçanta dhe të përgjithshme, ndajfoljet e vendit veçanta dhe të përgjithshme. Rrethanori i shkakut, paskajore në rasën kallëzore, në rasën gjinore me parafjalë. Ushtrime sintaksore.

#### **Java e katërt**

Rrethanori i gjendjes mund të jenë; emër në rasën kallëzore, fjali emërore, fjali foljore, e togfjalësh që sipas funksionit qëndrojnë në rasën kallëzore. Subjekti për të cilin flitet-përshkruhet gjendja e tij. Veçimi si gjymtyrë dytësore, bëhet përmes një përcaktori të shprehur me emër në rasën kallëzore pa parafjalë, që tregon karakteristikë sasiore, masën e veprimit, të gjendjes, të hapësirës, shkallën e një cilësie a mënyre veprimi.

### **Java e pestë: Kolokfiumi i parë**

#### **Java e gjashtë:**

Përjashtimi (الاستثناء), llojet e përjashtimit, përjashtimi i ngjitur, përjashtimi i ndarë, përjashtimi i plotë, përjashtimi i mangët, mjetet e përjashtimit, rasa e përjashtimit.

Thirrori, me pasthirmë dhe pa pasthirmë, rasa e thirrorit, pasthirrmat.

Ushtrime sintaksore.

#### **Java e shtatë:**

Kallëzuesori i foljes-كان - dhe foljeve të tjera të ngjashme me te.

Emërori i pjesëzës (إن) dhe pjesëzave tjera të ngjashme me te.

Kallëzuesori i pjesëzave - (لا-أ) dhe emërori i i pjesëzës mohuese përgjithësuese

#### **Java e tetë:**

Emri në arabishte, vihet në rasën gjinore në tri raste: Rasa gjinore me parafjalë, rasa gjinore me lidhje gjinore, rasa gjinore me përshtatje. Rasa gjinore me parafjalë- الجر بالحرف, parafjalët, kuptimet e parafjalëve, parafjalët e tepërta.

#### **Java e nëntë:**

Lidhja gjinore-التركيب الإضافي- gjymtyrët e lidhjes gjinore, llojet e lidhjeve gjinore, lidhja gjinore shprehësimore dhe lidhje gjinore kuptimore.

### **Java e dhjetë: kolokfiumi i dytë**

#### **Java e njëmbëdhjetë:**

Përcaktorët me përshtatje, Përcaktorët me përshtatje nuk kanë rasë të veçantë, klasifikohen në pesë grupe: cilësori, lidhori, përforcimi, zëvendësimi, ndajshtimi.

Përcaktorët me përshtatje, Përcaktorët me përshtatje nuk kanë rasë të veçantë, klasifikohen në pesë grupe: cilësori, lidhori, përforcimi, zëvendësimi, ndajshtimi.

#### **Java e njëmbëdhjetë:**

Cilësori (الصفة - النعت) - Llojet e cilësorit; Cilësori i drejtpërdrejtë, Cilësori i ndërmjetuar Lidhori (المعطوف), gjymtyrët e lidhorit, lidhëzat, kuptimet e tyre.

Përforcimi (التوكيد), llojet e përforcimit, Përforcimi leksikor, Përforcimi gramatikor.

#### **Java e dymbëdhjetë –**

Zëvendësimi (البدل), llojet e zëvendësimit, Zëvendësimi i një tërësie me tërësi, Zëvendësimi i tërësisë me një pjesë të saj, Zëvendësimi sipas një raporti, Zëvendësimi sqarues. Ndajshtimi (عطف البيان), llojet e tij. Ushtrime sintaksore.

#### **Java e trembëdhjetë:**

Fjalialia (الجملة), dy kryegjymtyrët e fjalisë, gjymtyrë të dyta, fjali emërore, fjali foljore.

Llojet e fjalive: Fjali pohore, Fjali mohore, Fjali kushtore, Fjali paskajore.

#### **Java e katërbëdhjetë:**

Fjali me funksion sintaksor dhe fjali pa funksion sintaksor.

#### **Java e pesëmbëdhjetë:**

**Provimi final - i fundit**

### **Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:**

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**  
Punimi seminarik: **10 pikë**  
Vlerësimi i kolokfiumit të parë: **20 pikë**  
Vlerësimi i kolokfiumit të dytë: **20 pikë**  
Provimi final: **40 pike**  
Total: **100%**

#### Literatura themelore - obliguese:

1 .Prof. Dr. Qazim Qazimi, “*Gramatika e gjuhës arabe*”, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2011, fq. 209-214.

2. الشيخ مصطفى غلاييني، جامعة الدروس العربية، الجزء الأول و الثاني و الثالث، الطبعة التاسعة والعشرون، المكتبة  
العصرية، بيروت-1994م.  
3. العربية بين يديك ..... .

#### Literatura plotësuese:

1. الدكتور أحمد شلبي، قواعد اللغة العربية، الطبعة الثالثة، المكتبة الأموية، بيروت، لبنان-1983، م.  
2. محمد محي الدين عبد الحميد، التحفة السننية بشرح المقدمة الأجرومية، الطبعة الخامسة عشرة، 1963، م.  
3. الدكتور أحمد حسن الرحيم، أحمد مصطفى الخطيب، مصطفى الملا البصري، قواعد اللغة العربية، مطبعة العاني-  
بغداد-1966، م.